Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

Gjuha (ët) e hartimit të ofertës është:

Shqip Anglisht

Tjetër _____

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë si më poshtë:

A) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

Sipas rëndësisë:

Çmimi pikët

_____ pikët

_____ pikët

_____ pikët

Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë pikët për cdo kriter vlerësimi të përcaktuar.

OSE

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave do të kryhet në bazën e shumës së çmimeve për njësi (Kjo metodë e vlerësimit nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore në rastet kur sasitë janë të vlerësueshme në bazë vjetore sipas përvojës së mëparshme dhe kur Marrëveshja Kuadër është përdorur për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në rast të tillë çmimi më i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët ofruar).

Mbetemi në pritje të marrjes së ofertës suaj.

[Drejtuesi i autoritetit /entit kontraktor]

Shtojca 3

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik i ftuar për të paraqitur ofertën)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë të realizojmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
5. Preventivin e çmimeve
6. Termat e referencës (nëse është rasti)

7. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
8. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
9. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/ Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**
_____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e listës së çmimeve duhet të hidhen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Çmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						

SHUMA TOTAL

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]
 [*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-
 se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 6

(Shtojce për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike

për

**Ndërhyrjet për përmirësimin e mjedisit natyror, nëpërmjet
rehabilitimit dhe ndërhyrjeve në zona apo territore të dëmtuara**

Përmbajtja

1.	Hyrje.....	3
2.	Objektivi i detyrës	4
3.	Zona e studimit dhe organizimi administrativ i territorit.....	5
4.	Objekti dhe përshkrimi i detyrave.....	9
	Faza A: Hartimi i projekteve teknike	
	Faza B: Implementimi i projekteve.	
5.	Profili i ekipit dhe personat kyç	
6.	Përgjegjësitë e Kontraktorit	
7.	Koordinimi me autoritetet vendore dhe qendrore	
8.	Konfidencialiteti i dokumentacionit	
9.	Kërkesat e raportimit	
10.	Kushtet e pagesës	
11.	Materiale në ndihmë të kontraktorit	

1. Hyrje

Ky dokument përmban Specifikimet teknike për “Ndërhyrjet për përmirësimin e mjedisit natyror, nëpërmjet rehabilitimit dhe ndërhyrjeve në zona apo territore të dëmtuara” që kryhen në funksion të “Programit të ndërhyrjeve të integruara 100 Fshatrat”, një program i iniciuar nga Qeveria Shqiptare dhe që zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Si një organizatë zhvillimore që i përgjigjet sfidave dhe partnerëve të saj në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, në kuadër të aktivitetit të tij dhe programit operacional 2021-2023, Fondi Shqiptar i Zhvillimit është duke zbatuar një seri ndërhyrjesh në kuadër të programit “100 Fshatrat” me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare. Aktualisht FSHZH mbart rolin si autoritet menaxhues për këtë set ndërhyrjesh, pjesë e programit të integruar për zhvillimin rural financiar nga Qeveria Shqiptare ku është alokuar një buxhet prej 2 mld leke të cilat do të shpërndahen në 12 ndërhyrje/projekte konkrete. Ky program është një model i zhvillimit të integruar e të qëndrueshëm duke u bazuar mbi potencialet turistike rurale, si dhe potencialin ekonomik të fshatrave të Shqipërisë.

Thelbi i programit “100 Fshatrat” është nxitja e rritjes ekonomike, punësimit dhe përmirësimit të cilësisë së jetës nëpërmjet investimeve strategjike në nivel lokal. Ky synim arrihet nëpërmjet përmirësimit të ofertës turistike të secilit prej fshatrave, ku potencial kryesor është parë eksperiencia që mund të ofrojnë. Në këto kushte, në kuadër të përmirësimit të ofertës turistike të këtyre fshatrave, është parë e domosdoshme realizimi i ndërhyrjeve të cilat japin një impakt të menjëhershëm pranë zonave që përbëjnë atraksion turistik.

Fenomeni i mjediseve natyrore të dëmtuara dhe atyre fizike të lëna pas dore është i pranishëm gjerësisht duke krijuar imazhin e një territori të dëmtuar e painvestuar. Në këtë mënyrë të tilla mjedise shenjojnë “vraga” në territor. Këto “vraga” në pëlhurën e mjedisit fizik kanë nevojë të shoqërohen me investime të posaçme publike që do të valorizojnë zonat me potencial të lartë turistik në të cilat ndodhen por në të njëjtën kohë do të japin një mesazh të fortë të zhvillimit.

Për të realizuar në mënyrë objektive aktivizimin e këtyre “vragave” është e nevojshme që këto lokacione të trajtohen në mënyrë të tillë që të përfaqsojnë një impuls pozitiv dhe një ndryshim rrënjësor të imazhit. Në këtë këndvështrim duhen konsideruar mundësitë e zhvillimit të lokacioneve me potencial për aktivitetet e turizmit të aventurës, turizmit natyror dhe kulturor.

Në funksion të projektimit dhe përgatitjes për zbatim të investimeve strategjike, të cilat do të sjellin një përmirësim të peisazhit dhe rehabilitim të lokacioneve specifike, FSHZH ka identifikuar një long-list me lokacione të cilat paraqesin potencial për realizimin e ndërhyrjeve rikuperuese. Lokacionet janë piketuar pas një skanimit të territorit dhe janë gjykuar si pika me impakt të ndjeshëm në rastin e realizimit të një ndërhyrje. Këto ndërhyrje do të duhet të përbëjnë landmark-e për zonën, aksin rrugor etj. dhe duhet të synojnë përmirësimin e peisazheve natyrore nëpërmjet funksionalizimit të lokacioneve të dëmtuara.

2. Objektivi i detyrës

Nëpërmjet kësaj detyre synohet të realizohet projektimi dhe zbatimi i ndërhyrjeve në territoret e parashikuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Është me rëndësi të theksohet që këto ndërhyrje duhet të paraqesin një impuls domethënës në drejtim të zhvillimit.

Ndërhyrja parashikon rikonceptimin e nje hapësire te degraduar në peisazhin natyror në territorin e “100 Fshatrave” apo përgjatë rrugës së aksesit që të con aty. Llojet e dëmtimeve që parashikohet të rikuperohen janë të tipologjisë së djegieve, gërryerjeve, mbetjeve urbane etj. Fokusuar konkretisht në zonën përgjatë lumit të Vlorës, fshatit Voskopojë dhe në zonen e Kelmendit sipas rajoneve përkatëse. Qëllimi është rigjenerimi i zonës së degraduar me prekje sa më minimale, por që ngjallin interes dhe besim, ndërhyrje “impuls” që japin mesazhin e transformimit estetik të një mjedisi të pamirëmbajtur, të riciklimit të një difekti në një hapësire funksionale në shërbim të komunitetit. Kjo ndërhyrje do të parashikojë të vendosi disa pika atraksioni / landmark-e në territor në vend të dëmtimeve, duke përdorur teknika të ndryshme, nga instalacionet dhe arti, tek kthimi në hapësira funksionale për komunitetin dhe turistet ku filozofia duhet të jetë impakti pozitiv.

Kryesisht ndërhyrjet e identifikuar konsistojnë në propozime të cilat ndodhen përgjatë akseve lidhëse me zona turistike, pëgjithësisht në lokacione të cilat paraqesin rreziqe shkarje, sistemime terreni ose mjedise të dëmtuara natyrore të cilat paraqesin mundësi shfrytëzimi për rekreacion. Gjithashtu si pjesë e propozimeve vijnë edhe elementë pjesë e trashëgimisë kulturore si ura, monumente të trashëgimisë historike apo çezma publike të cilat përbëjnë aset shërbimi, kulturor edhe turizmi të cilat mund të shërbejnë si pika pushimi përgjatë rrugës. Propozohen si të përshtatshme për ndërhyrje edhe ish-kapanone të cilat përbëjnë potencial me interes të vecantë në tipologjitë adaptive.

Llojet e problematikave që parashikon të rrigjenerohen nga kjo ndërhyrje duhet ti përkasin këtyre kategorive në zonat e mesiperme

1. trashëgimi kulturore apo natyrore fizike e demtuar si ndertesa apo vende/objekte historike ne natyre (mulli, vend kuvendimi,monumente të trshëgimisë historike, rrap, etc).
2. dëmtime te pelhures natyrore si: djegie, shpyllëzim, gërryerje, vendgrumbullim I paligjshem mbeturinash, bankina te perrenjve apo lumenjve.
3. ndertesa te rrenuara qe demtojne peisazhin dhe ulin vleren e atraksionit (ish stalla, objekte industrial, objekte ushtarake etj)
4. demtime te tjera qe mund te konsiderohen me rendesi per tu rigjeneruar nga kjo nderhyrje qe vleresohen si te rendesishme nga ekipi I verifikimit ne terren

Produktet konkrete që kontraktori do të dorëzojë në kuadër të këtij shërbimi janë:

- Përgatitja e projekteve teknike për zbatim mbi koncept idenë e siguruar nga FSHZH.
- Zbatimi i projekteve teknike.
- Të tjera në funksion të objektivit të lartpërmendur, sipas kërkeses së Autoritetit Kontraktues

3. Zona e studimit dhe organizimi administrativ i territorit

Subjekti i kësaj kontrate është territori i 100+ Fshatrave dhe do të synojë shtrirjen në formen e grup-fshatrave/ clusterave dhe aty ku është e mundur edhe në nivel fshati. Përfitues të kësaj ndërhyrje parashikohet të jenë banorët, bizneset e industrisë turistike (njësitë akomoduese,

restoranteria, guidat turistike, etj.) Turistët dhe vizitorët e këtyre fshatrave turistike do të jenë gjithashtu përfitues të kësaj ndërhyrjeje. Territori i parashikuar nga FSHZH, fokusuar kryesisht në pikat e identifikuara si më poshtë është orientues por jo kufizues.

4. Objekti dhe përshkrimi i detyrave

Objekti i kësaj detyre dhe synimi i këtij investimi është realizimi i ndërhyrjeve rehabilituese në mjedise natyrore të dëmtuara nëpërmjet valorizimit dhe funksionalizimit të tyre, duke patur si objektiv hartimin e **projektit të zbatimit** bazuar në projekt-idetë e hartuara nga FSHZH, realizimin e punimeve të ndërtimit dhe dorëzimin e objekteve të punës të përfundura me “**çelësa në dorë**”. Objekti i punës së kësaj ndërhyrjeje do të realizohet nëpërmjet kryerjes së detyrave të listuara më poshtë:

Përshkrimi i detyrave:

Faza A: Hartimi i projekteve teknike të zbatimit

Hartimi i Projekteve të Zbatimit.

Kontraktori pritet të prodhojë projektet e zbatimit për disa prej ndërhyrjeve që do të përcaktohen në bashkëpunim me FSHZH.

Gjatë kësaj faze Kontraktori duhet që të përfshijë dhe aktivitetet e mëposhtme:

- Kryerjen e vëzhgimeve që synojnë në eliminimin e hamëndshmërisë të bëra gjatë fazave më të hereshme
- Përditesimin e llogaritjeve dhe zevëndësimin e hamëndësimeve të bëra më parë
- Pregatitjen e metodologjisë së përgjithshme të ndërtimit
- Pregatitjen e grafikut paraprak të programit të punimeve
- Pregatitjen e vlerësimit paraprak të kostos
- Ndikimet ndaj mjedisit
- Konsultimin me publikun

Projekt-zbatimi duhet që të paraqesë në formë të detajuar teknike zgjidhjet përfundimtare të varianteve të propozuara të projektit. Kontraktori gjatë kësaj faze do të pregatisë dhe të paraqesë për miratim studimet që vijojnë:

-Studimi Topografik - Për këtë qëllim do të kryhet një rilevim topografik (i relievit dhe kuotave të terrenit) i cili do të hartohet nga Kontraktori dhe duhet të jetë i firmosur dhe vulosur edhe nga specialisti topograf.

-Studimi gjeologjik - Studimi gjeologjik duhet të trajtojë të gjitha çështjet që lidhen me qëndrueshmërinë e dherave, veçanërisht rëndësi e veçantë duhet ti kushtohet studimit të vendeve ku do të parashikohen vepra arti (tombino, tunele, ura, etj.). Studimi do të shoqerohet dhe me fotografi të cilat së bashku me hartat dhe shpimet e kryera do të shërbejnë për të konfirmuar rezultatet e përfshira në studimin gjeoteknik. Studimi do të ketë datë dhe të jetë i konfirmuar nga specialisti gjeoteknik apo grupi i projektimit gjeoteknik.

Studimi Hidrologjik - Ne kete studim duhen të vlerësohen kushtet hidrologjike duke përfshirë dhe studimin e drenazhimit të ujrave sipërfaqesore dhe nëntokësore. Në përfundim të këtij studimi do të përgatitet Raporti Hidrologjik i cili do të ketë datë dhe të jetë i firmosur nga specialisti hidrolog.

Studimi i projektimit - Ky studim do të shtrihet për një periudhë 20-vjeçare për materialet fleksibël ndërsa për ato rigjide do të shtrihet për një periudhë 40-vjeçare. Ky raport do të ketë datë dhe do të konfirmohet nga inxhinieri i projektimit.

Metodologjia e Ndërtimit - Kontraktori do të përshkruajë mënyrën se si do të ndërtohet vepra nga pikpamja teknike, logjistike dhe programore në përputhje me elementët teknikë të projektit. Këtu duhen theksuar rreziqet e veçanta në të cilat do të ndeshet Kontraktori dhe menyrat se si do të perballohen ato prej tij. Ky raport do të ketë datë dhe të firmoset nga inxhinieri i projektimit.

Kërkesat për leje apo liçensa - Në këtë raport Kontraktori do të raportojë për lejet apo kërkesat që duhen marrë gjatë fazave të projektimit dhe ndërtimit të objektit.

Raporti mbi konsultimin e publikut - Ky raport do të përmbledhë të gjitha propozimet e konsultimit me publikun, me aktorët tjerë të interesuar

Vizatimet - Kontraktori duhet të paraqesë vizatimet e mëposhtme duke organizuar pjesën bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve:

- Horografia në shkallën 1: 10 000, 1:5000, ose 1:2000. Në rastet kur zona e studimit është shumë e madhe duhet të përgatitet një hartë përmbledhëse në një shkallë të përshtatshme
- Planimetri në shkallë 1:1000; 1:500; 1:200
- Profil gjatësor H 1:1000 V 1: 100
- Profilat tërthore SH 1: 200; 1:100
- Profila tërthor tip SH 1:25; 1:50
- Harta e rievimit topografik SH 1;1000; 1:500; 1:200
- Harta hidrollogjike SH 1:5 000
- Harta gjeologjike SH 1:1 000; 1:500; 1:200
- Vizatime të mureve mbajtës apo pritës etj. SH 1: 50: 1:100

Projekti i zbatimit në këtë fazë do të përmbillet me raportin teknik në të cilin përmbledhet i gjithë materiali teknik për fazat e zbatimit. Në të përfshihen planimetritë dhe informacione të tjera të rëndësishme siç janë studime të vecanta, foto, etj. Raporti i projektit teknik mbasi firmoset dhe vulozet nga Kontraktori paraqitet tek Autoriteti Kontraktual, në formë zyrtare për shqyrtim dhe miratim.

Realizimi i kontratës bazuar në konceptin “*Me çelësa në dorë*”, kërkon që subjekti kontraktues të jetë i aftë të realizoj kushtet dhe përcaktimet e autoritetit kontraktor për plotësimin e të gjitha fazave të specifikuar në përshkrimin e punës, nisur nga programimi i burimeve njerëzore dhe makinerive, projektimi, marrja e lejeve të ndërtimit, realizimi i punimeve paraprake në kantierin e ndërtimit, ndërtimi objekteve dhe sipërfaqeve të hapura, lidhja me rrjetet e infrastrukturave dhe dorëzimi i objektit sipas *kohës, cilësisë të çertifikuar sipas standardeve, vlerës financiare* të përcaktuar dhe kushteve të legjislacionit e termave të kësaj kontrate, duke garantuar se në përfundim objekti që do të merret në dorëzim do të jetë funksional.

Pavarësisht kushteve dhe specifikimeve të përcaktuara nga teknologja e ndërtimit, përgjegjësia për funksionimin e produktit të kësaj kontrate “*Me çelësa në dorë*”, kundrejt cilësisë i takon kontraktuesit, i cili duhet të siguroj një garanci jo më pak se 2 (dy) vjet, nga momenti i dorëzimit të objektit te autoriteti kontraktor. Brenda kësaj periudhe kohore duhet të garantohet se objekti i kësaj kontrate do jetë terësisht funksional, sipas përcaktimeve të ofertuara.

5. Profili i ekipit dhe personat kyç

Për realizimin e objekti te kontrates kërkohet një ekip multidisiplinar dhe personel teknik.

- 1 (Nje) Inxhinier ndertimi me të paktën 10 vjet eksperience ne te pergjitheshme ne profesion
- 1 (Nje) arkitekt
- 1 (Nje) inxhinier hidro teknik me të paktën 5 vjet eksperience
- 1 (Nje) inxhinier elektrik me të paktën 5 vjet eksperience ne profesion
- 1 (Nje) inxhinier mjedisi me të paktën 5 vjet eksperience ne profesion
- 1 (Nje) inxhinier gjeodet/markshajder me të paktën 5 vjet eksperience ne profesion dhe 5 vite eksperiencë specifike në zbatimin e punimeve për objekte të ngjashme

6. Përgjegjësitë e Kontraktorit

Kontraktori është përgjegjës për realizimin në tërësi të detyrave të përcaktuara në objektivat e detyrës së ngarkuar, ai do të realizojë të gjitha proceset e punës të nevojshme për të bërë të mundur realizimin e objekteve të plota funksionale, në formë, sipërfaqe dhe volume në përputhje me standardet e ndërtimit për të përmbushur detyrimet e përcaktuara nga projekt idetë e FSHZH.

Në këtë rast autoriteti përgjegjës do të ofrojë modelin fillestar (preliminary design) dhe kontraktuesi duhet të ndjekë këtë model. Koncepti është që kontraktori do ta dorëzojë objektin plotësisht në gjendje operative. Vëllimi i punëve i parashikuar në projekt, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit.

Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e përgatitjes së projektit të detajuar, marrjes së oponencës teknike si dhe realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

Vlera e ofruar nuk ndryshon, përvec se në rastet kur objekti i punës zvogëlohet (kërkohet dhe/ose miratohet nga autoriteti përgjegjës dhe vlera e kontratës do reduktohet në përpjestim me këtë zvogëlim)

7. Koordinimi me autoritetet vendore dhe qëndrore

Kontraktori do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me FSHZH, që është përgjegjës për menaxhimin e realizimit të detyrës.

Në nivel qëndror, Kontraktori nëpërmjet FSHZH mund të konsultohet me cdo institucion i cili është palë e interesuar. Pjesë e komunikimit dhe konsultimeve mund të jenë edhe institucione të tjera të cilat gjykohet se mund të kontribuojnë në këtë kontratë.

8. Konfidencialiteti i dokumentacionit

Kontraktori do të trajtojë në mënyrë konfidenciale informacionin e marrë dhe të përftuar gjatë detyrës dhe do ta përdorë atë vetëm në shërbim të kryerjes së kësaj detyre. Kontraktori nuk mund t'ju ofrojë palëve të treta rezultatet e këtij studimi pa autorizim paraprak.

9. Kërkesat e raportimit

- Kontraktori do raportojë pranë FSHZH;
- FSHZH do të monitorojë aktivitetet e Kontraktori;
- Kontraktori duhet të ofrojë informacion sa herë që ti kërkohet;
- FSHZH do të rishikojë dhe aprovojë të gjitha dokumentet e dorëzuara nga Kontraktori.

10. Kushtet e pagesës

Pagesa për shërbimin e ofruar do të bëhet sipas përcaktimeve në kushtet e vecanta të kontratës.

11. Materiale në ndihmë të Kontraktorit

Analizat dhe konceptet e përgatitura në kuadër të Programit të 100 fshatrave të cilat do të vihen në dispozicion nga FSHZH. VKM nr.21 datë 12.1.2018 “Për disa shtesa në vendimin nr. 709, datë 29.10.2014, të këshillit të ministrave, “për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014– 2020”

Zerat e parashikuara jo shteruese: Punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N-Z/A/7 Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rruge, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane.

1. Punime për konservimin, restaurimin e godinave brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane me status monument (përfshirë instalimet e ndryshme në funksion të objektit)
2. Punime për konservimin, restaurimin, konsolidimin, forcimin strukturor të godinave brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane pa status monument (përfshirë instalimet e ndryshme në funksion të objektit,)
2. Punime për rikualifikim të hapësirave (shesheve)
3. Punime për rehabilitim të rrugëve
4. Punime për rehabilitim të infrastrukurës nëntokesore, (ujesjelles kanalizime, instalime tel. Ndricim etj)
- 5 Punime ndricimi

Licence me kod III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte”

- N.P – 1. A Punime gjermimi në tokë.
- N.P – 2. A Ndertime civile dhe industriale
- N.P – 3. A Rikonstruksione dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada
- N.P – 4. A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha tramvaj metro, pista aeroportuale.
- N.P – 7. A Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi dhe vaditje.
- N.P – 9 A Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime
- N.P – 11. A Ndertime për n/Stacionet, kabinat e transformatoreve, linja e TM dhe shpërndarjen e energjisë
- N.P – 12. A Punime të inxhinierisë së mjedisit.

2. Punimet speciale të ndërtimit kompania duhet të keyë liçencat e mëposhtme:

- N S – 1. A Punime për prishjen e ndertimeve
 - 1. Punime prishje të ndertimeve
- N S – 4. A Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndertuese
 - 1. Punime murature guri e tulle për themele dhe në lartësi,
 - 2. Punime betoni dhe beton armë,
 - 3. Punime hekur betoni,
 - 4. Punime hidroizolimi dhe çatie,
 - 5. Punime shtresash,
 - 6. Punime tavani dhe suvatimi,
 - 7. Punime punime suvatimi dhe veshje me pllaka,
 - 8. punime për dyer e dritare,
 - 9. punime bojatisje,
 - 10. punime skelerie dhe kallepi,
 - 11. Punime elektrike,
 - 12. punime hidrosanitare,
 - 13. punime kanalizimi,
 - 14. punime termoizolimi dhe ngrohje dhe
 - 15. punime të ndryshme speciale e prishje
- N.S – 7 A Barriera dhe mbrojtje rrugore
 - 1. Punime të sinjalistikës rrugore
- N.S – 8. A Ndertim parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri
 - 1. Punime beton dhe beton armë tek godinat dhe rruget
 - 2. Punime hekuri dhe betoni
 - 3. Punime hekurudhore që kanë të bëjnë me traversat dhe shtyllat

4. Punime te ndryshme qe kane te bejne me konstruksionet metalike ne ndertesa modulare prej xhami ose materiali tjetër dhe prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.

N S – 12 A Impiante teknologjik, termike dhe te kondicionimit

1. Punime elektrike
2. Punime hidrosanitare
3. Punime ngrohje dhe termoizolimi

N S – 18 A Punime topogjeodezike

Shtojca 8

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve: 36 muaj

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

J

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5 ;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*)

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit dhe merre përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore

për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2018, 2019, 2020, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- situacion punimesh
- Fatura tatimore për çdo situacion punimesh
- Akt kolaudimi;

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- N.P – 1. A Punime gjermimi në tokë.
- N.P – 2. A Ndertime civile dhe industriale
- N.P – 3. A Rikonstruksione dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada
- N.P – 4. A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha tramvaj metro, pista aeroportuale.
- N.P – 7. A Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi dhe vaditje.
- N.P – 9. A Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime
- N.P – 11. A Ndertime per n/Stacionet, kabinat e transformatoreve, linja e TM dhe shperndarjen e energjise
- N.P – 12. A Punime te inxhinierise se mjedisit.

N-Z/A/7 Zbatim ne konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rruge, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane.

Për punimet e speciale të ndërtimit kompania duhet të keyë liçencat e mëposhtme:

- N S – 1. A Punime per prishjen e ndertimeve
- N S – 4. A Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese
- N.S – 7. A
- N.S – 8. A Nderitim parafabrikat me beton te armuar, struktura metalike dhe druri
- N S – 12. A Impiante teknologjik, termike dhe te kondicionimit
- N S – 18. A Punime topogjeodezike

Licence Kodi III.2. B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane”.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të kete ne stafin e tij teknik per te gjithë periudhen e zbatimit minimalisht:

- 1(Nje) Inxhinier ndertimi me të paktën 10 vjet eksperience ne te pergjitheshme ne profesion
- 1 (Nje) arkitekt
- 1 (Nje) inxhinier hidro teknik me të paktën 5 vjet eksperience
- 1 (Nje) inxhinier elektrik me të paktën 5 vjet eksperience ne profesion
- 1 (Nje) inxhinier mjedisi me të paktën 5 vjet eksperience ne profesion
- 1 (Nje) inxhinier gjeodet/markshajder me të paktën 5 vjet eksperience ne profesion dhe 5 vite eksperiencë specifike në zbatimin e punimeve për objekte të ngjashme

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV dhe deshmi/reference/dokumentacion te leshuar nga punedhenes te meparshem ose perfituesit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të stafit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merrem masa për ndërprerjen e kontratës

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e leshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diploma/certifikata
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merrem masa për ndërprerjen e kontratës

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 50 persona për periudhën qershor 2021- gusht 2021e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të leshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën qershor 2021- gusht 2021
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën qershor 2021- gusht 2021.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, do te paraqiten perpara se AK te jape marreveshjen kuader.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet ne pronesi ose qira/kontrate furnizimi, si me mëposhte:

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion i vogel me kapacitet nga 1 deri ne 6 ton	Cope	3	<i>në pronësi ose me qira</i>
2	Kamion me kapacitet mbajtes nga 10-18 (ton)	Cope	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
3	Impiant automatic betoni	Copë	1	<i>në pronësi ose me qira</i>
4	Mjet Auto-Vinç	Copë	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
5	Kompresor ajri	Copë	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
6	Eskavator me zingjir	Cope	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
7	Eskavator me goma	Copë	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
8	Mini eskavator	Copë	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
9	Kompaktor	Copë	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
10	Autobetoniere	Copë	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
11	Pompe Betoni	Copë	1	<i>në pronësi ose me qira</i>
12	Fadrome Kove para dhe mbrapa	Copë	2	<i>në pronësi ose me qira</i>
13	Rrul gome – hekur (kapaciteti jo me pak se 12 ton)	Copë	2	<i>në pronësi ose me qira</i>

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

- d) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkuara, do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrate. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjate afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

-Përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

-Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe.

